LIGJ
Nr. 123/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9324, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHJE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë (në tekstin e mëposhtëm Palë Kontraktuese),
me dëshirën për t'i rregulluar marrëdhëniet e ndërsjella në fushën e mbrojtjes shoqërore,
kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimi i termave

1) Përkufizimi i termave, në kuptim të kësaj marrëveshjeje, është si më poshtë vijon:
1. "Dispozita ligjore", ligje, akte nënligjore dhe dispozita të tjera, që u referohen fushave të caktuara të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje;
2. "Organ kompetent", ministritë që janë kompetente në lidhje me dispozitat ligjore të nenit 2, paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje;
3. "Institucionet", në Republikën e Shqipërisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Kujdesit Shëndetësor.
Në Republikën e Maqedonisë, Fondi për Sigurimet Shoqërore dhe të Invaliditetit të Maqedonisë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në Maqedoni.
4. "Institucioni kompetent", institucioni tek i cili personi është i siguruar gjatë kohës së paraqitjes

së kërkesës për përfitim ose prej të cilit ka apo mund të ketë të drejtën e përfitimit;

5. "I siguruari", personi që është i siguruar apo ka qenë i siguruar sipas dispozitave ligjore të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje.

6. "Anëtar i familjes", anëtari i familjes përcaktohet sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese, dispozitat e së cilës zbatohen.

7. "Vendbanim", vendbanim i përhershëm.

8. "Vendqëndrim", vendqëndrimi i për-kohshëm.

9. "Periudha e sigurimit", për Republikën e Shqipërisë: Çdo periudhë e kontributeve të paguara, vitet e punës, aktiviteti profesional, si dhe çdo periudhë e tillë e ekuivalentuar me periudhën e sigurimit sipas legjislacionit shqiptar.

Për Republikën e Maqedonisë: periudhat për të cilat janë paguar kontributet dhe periudhat që njihen si të tilla.

10. "Përfitim", përfitimi në natyrë dhe përfitimi në para.

11. "Përfitimi në natyrë" janë përfitimet që garantohen sipas dispozitave ligjore të secilës palë kontraktuese, përveç përfitimeve në para.

12. "Përfitimi në para", pensioni dhe përfitimet e tjera në para, duke përfshirë edhe rimbursimet, kompensimet, indeksimet dhe rritjet sipas dispozitave ligjore të përcaktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

13. "Ofrimi i ndihmës së shpejtë shëndetësore", përfitimi në natyrë që s'mund të shtyhet, pasi në të kundërt do të rrezikohej seriozisht jeta dhe shëndeti i personit.

2. Termat e tjerë, që nuk janë përfshirë në paragrafin 1 të këtij neni, do të trajtohen sipas përkufizimit që ata kanë në dispozitat ligjore të palëve kontraktuese.

Neni 2

Hapësirat ligjore

1. Kjo marrëveshje bazohet në:

1.1 Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë për:

1.1.1 Sigurimet shoqërore për personat e punësuar, në lidhje me:

1.1.1.1 paaftësinë e përkohshme për punë për shkak të sëmundjes;

1.1.1.2 barrëlindjen;

1.1.1.3 pleqërinë, invaliditetin, si dhe humbjen e mbajtësit të familjes;

1.1.1.4 aksidentin në punë dhe sëmundjen profesionale.

1.1.2 Sigurimet shoqërore për personat e tjerë ekonomikisht aktivë (të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit), në lidhje me:

1.1.2.1 barrëlindjen;

1.1.2.2 pleqërinë, invaliditetin, si dhe humbjen e mbajtësit të familjes;

1.1.3 kujdes të detyrueshëm shëndetësor në rast sigurimi të detyrueshëm.

1.2 Dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë, për:

1.2.1 sigurimin për pension dhe invaliditet;

1.2.2 sigurimin shëndetësor, kujdesin shëndetësor dhe barrëlindjen;

1.2.3 aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për të gjitha dispozitat ligjore me të cilat ndryshohen ose plotësohen dispozitat ligjore të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo marrëveshje do të zbatohet edhe për dispozitat ligjore që do t'i zgjerojnë skemat aktuale me kategori të reja përfituesish, në rast se në lidhje me këtë nuk ka kundërshtime nga pala kontraktuese, e cila ka ndryshuar legjislacionin e saj, për të cilën pala tjetër kontraktuese do të njoftohet brenda gjashtë muajve nga publikimi zyrtar i akteve të cilësuara.

4. Kjo marrëveshje nuk zbatohet për dispozitat ligjore me të cilat parashikohet degë e re e sigurimeve shoqërore, vetëm nëse për këtë qëllim nuk arrihet marrëveshje midis institucioneve kompetente të palëve kontraktuese.

Neni 3
Fusha e zbatimit për personat

Nëse nuk është parashikuar ndryshe, kjo marrëveshje, do të zbatohet për të gjithë personat që janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të secilës prej palëve kontraktuese dhe për personat e tjerë që i gëzojnë këto të drejta prej tij.

Neni 4
Trajtimi i barabartë

Nëse nuk është parashikuar ndryshime me këtë marrëveshje, të gjithë personat e përfshirë në këtë marrëveshje do të trajtohen në mënyrë të barabartë prej palëve kontraktuese në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për plotësimin e kushteve dhe pagesën e përfitimeve që rrjedhin drejtpërdrejt prej legjislacionit të palëve kontraktuese ose sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5
Transferimi i përfitimeve

1. Përfitimet e fituara në bazë të legjislacionit të njërës palë kontraktuese nuk mund të reduktohen, ndryshohen, ndërpriten apo anulohen për shkak se përfituesi ka vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe me këtë marrëveshje.
2. Për personat që kanë të drejtën e përfitimit nga njëra palë kontraktuese, transferimi i përfitimit sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet në kushte të njëjta edhe në rastet kur ata jetojnë në një shtet të tretë.
3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për rastet e pensionit minimal.

PJESA II
DISPOZITAT LIGJORE TË ZBATUESHME

Neni 6
Dispozitat e përgjithshme

Detyrimi i personit për t'u siguruar sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet në bazë të dispozitave ligjore të palës kontraktuese në territorin e të cilit ai punon. Ky sigurim vlen edhe në rastet kur adresa e punëdhënësit gjendet në territorin e palës tjetër kontraktuese, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me dispozitat e neneve 7 dhe 8 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7
Dispozita të posaçme

1. Në rast se punëdhënësi me adresë në territorin e njërës palë kontraktuese dërgon një punonjës në territorin e palës tjetër kontraktuese, për të, jo më shumë se 24 muaj kalendarikë prej ditës së dërgimit, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet.
2. Në rastet kur personi që ushtron aktivitet të pavarur në territorin e njërës palë kontraktuese shkon përkohësisht për të ushtruar aktivitetin në palën tjetër kontraktuese, për të, jo më shumë se 12 muaj kalendarikë prej ditës së largimit të tij, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese sikur ai ta ushtrojë këtë aktivitet në territorin e vet.
3. Në rastet kur një ndërmarrje e transportit ajror apo tokësor me adresë në territorin e njërës palë

kontraktuese dërgon një punëtor në territorin e palës tjetër kontraktuese, zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet.

4. Për ekuipazhin e anijeve dhe të punësuarit e tjerë në anije, zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese, flamurin e së cilës mban anija që lundron.

5. Për personat që ushtrojnë aktivitetin e ngarkimit, shkarkimit, riparimit apo mbikëqyrjes së anijes në portet e palës tjetër kontraktuese, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese të cilës i përket porti.

6. Nëse një ndërmarrje me adresë në territorin e njërës palës kontraktuese, dërgon punëtorë në filialin e saj në territorin e palës tjetër kontraktuese, për të do të zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese, sikur ai të jetë i punësuar në territorin e vet; për një periudhë kohore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

7. Për punonjësit e administratës publike dhe shtetërore, përfaqësuesit zyrtarë dhe personat që kanë të njëjtin status me ta të dërguar në shtetin tjetër kontraktues, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese që i ka dërguar.

8. Mund të zbatohen dispozitat ligjore të palës së parë kontraktuese prej paragrafit 1, 2 dhe 6 të këtij neni, me përjashtim të kërkesës së përbashkët të punëdhënësit dhe të të punësuarit, respektivisht me kërkesë të personit që ushtron aktivitet të pavarur dhe me miratimin e organit kompetent të palës tjetër kontraktuese, që të ketë mundësi për të vazhduar edhe 12 muajt e tjerë.

Neni 8

Punonjësit e misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore

1. Për punonjësit e misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore dhe personat që kanë të njëjtin status me ta, si dhe të punësuarit si shërbime private shtëpiake tek anëtarët e këtyre misioneve dhe përfaqësive, të dërguara në territorin e palës tjetër kontraktuese, do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese që i ka dërguar.

2. Për punonjësit prej paragrafit 1 të këtij neni që nuk janë dërguar, zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese në të cilën janë punësuar, ndërsa misionet diplomatike, respektivisht përfaqësitë konsullore, d.m.th. anëtarët e tyre që i kanë punësuar, janë të detyruar t'u përmbahen dispozitat ligjore të atij shteti që janë të vlefshme edhe për punëdhënësin.

3. Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, të punësuarit, të cilët janë shtetas të palës kontraktuese që i përket misionit diplomatik, respektivisht përfaqësisë konsullore, kanë mundësi që në një afat prej 3 muajsh nga dita e punësimit të vendosin për zbatimin e dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese.

Neni 9

Përjashtimet

Me kërkesë të përbashkët nga i punësuari dhe punëdhënësit të tij, respektivisht personi që ushtron aktivitet të pavarur, organet kompetente të palës kontraktuese mund t'i përcaktojnë përjashtimet prej dispozitave të neneve 7 dhe 8 të kësaj marrëveshjeje dhe gjatë kësaj duhet të merren parasysh lloji dhe rrethanat e punësimit.

PJESA III

DISPOZITA TË POSAÇME

KREU 1

SËMUNDJET DHE BARRËLINDJA

Neni 10

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Periudhat e sigurimit, të plotësuara sipas dispozitat ligjore të të dyja palëve kontraktuese, kur kjo nevojitet, bashkohen për realizimin e së drejtës së përfitimit dhe përcaktimin e kohë-zgjatjes së këtij përfitimi, me kusht që ato të mos mbivendosen.

Neni 11
Përfitimi në natyrë

1. Personi i cili i plotëson për të drejtën e përfitimit në natyrë sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, ka të drejtën e kujdesit shëndetësor nga ana e institucionit ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin e tij, në masën, llojin dhe mënyrën e përfitimit sipas dispozitave ligjore që janë të vlefshme për atë institucion, sikur të jetë i siguruar tek ai, por për një periudhë kohore të përcaktuar sipas dispozitave ligjore që janë të vlefshme për institucionin kompetent, i cili ka përgjegjësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor, me kusht që:

1.1 të ketë vendbanim të përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese; ose:

1.2 të ketë vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, sipas nenit 7, paragrafët 1, 2, 3, 6 dhe 7 dhe nenit 8, paragrafi 1 të kësaj marrë-veshjeje; ose

1.3 gjendja e tij gjatë kohës së vendqëndrimit te pala tjetër kontraktuese kërkon ofrimin urgjent të ndihmës shëndetësore, me kusht që personi të mos ketë shkuar për trajtim shëndetësor te pala tjetër kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen edhe për anëtarin e familjes që ka vendbanim në territorin e palës tjetër kontraktuese.

3. Personi, i cili do të marrë miratimin nga institucioni kompetent i njërës palë kontraktuese që të dërgohet për trajtim mjekësor në territorin e palës tjetër kontraktuese, përkatësisht kur e kërkon gjendja e tij shëndetësore, ka të drejtën e përfitimit në natyrë nga institucioni që ndodhet në vendqëndrimin e tij të përkohshëm, sipas dispozitave ligjore që vlejnë për atë institucion, sikur të jetë i siguruar tek ai, por në ngarkim të institucionit kompetent.

4. Për lejimin e përdorimit të protezave, pajisjeve ortopedike ose aparateve të tjera të ngjashme me to dhe përfitimet në natyrë, që kanë vlerë të madhe, nevojitet miratimi paraprak i institucionit kompetent, përveç rasteve kur ofrimi i atyre shërbimeve është urgjent, duke marrë në konsideratë jetën dhe shëndetin e personit.

Lista e shërbimeve të sipërpërmendura do të përcaktohet me marrëveshje administrative sipas nenit 30 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12
Përfitimet në para

Përfitimi sipas nenit 11 të kësaj marrëveshjeje, si dhe në rastet e barrëlindjes, miratohet nga institucioni kompetent sipas dispozitave ligjore që ajo po zbaton.

Neni 13
Përfitimet e pensionistëve

1. Për pensionistët që kanë përfituar pensionin sipas dispozitave ligjore të të dyja palëve kontraktuese, në mënyrë ekskluzive do të zbatohen dispozitat ligjore të palës kontraktuese në të cilën përfituesi ka vendbanimin e tij.

2. Përfituesi sipas paragrafit 1 të këtij neni, të drejtën e përfitimit në natyrë e realizon nga institucioni kompetent i palës kontraktuese ku ka vendbanimin e tij.

3. Për pensionistët që kanë përfituar pensionin sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, të cilët kanë vendbanim të përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese, e drejta e përfitimit në natyrë sigurohet sipas dispozitave ligjore të palës kontraktuese në territorin e së cilës ka vendbanimin,

sikur e drejta për pension të jetë realizuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore, por në ngarkim të institucionit kompetent.

4. Përfituesi i pensionit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, me vendbanim të përhershëm në njërën nga palët kontraktuese, gjendja e të cilit gjatë kohës së qëndrimit në palën tjetër kontraktuese, kërkon sigurimin e menjëhershëm të përfitimit në natyrë, ka të drejtën e këtij përfitimi sipas dispozitave ligjore dhe në ngarkim të institucionit të palës tjetër kontraktuese.

5. Dispozitat e paragrafit 1 deri te 4 të këtij neni zbatohen dhe për anëtarët e familjes së përfituesit, në rast se banojnë me të dhe nuk janë të siguruar sipas ndonjë skeme tjetër.

Neni 14

Institucioni kompetent që siguron përfitimin në natyrë

Për rastet e neneve 11 dhe 13 të kësaj marrë-veshjeje, përfitimin në natyrë e siguron në:

1. Republikën e Shqipërisë - Instituti i Kujdesit Shëndetësor;
2. Republikën e Maqedonisë - Shërbimi Rajonal i Fondit për Sigurimin Shëndetësor të Maqedonisë.

Neni 15

Rimbursimi i shpenzimeve

1. Institucioni kompetent do t'ia rimbursojë institucionit tjetër kompetent shpenzimet për përfitimet në natyrë, të dhënat për personat sipas nenit 11, paragrafët 1, 3 dhe 4 dhe nenit 13, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve administrative. Institucionet do të bien dakord për mënyrën e rimbursimit të shpen-zimeve në bazë të vlerës reale të shpenzimit ose shumës fikse.

2. Rimbursimet e shpenzimeve për anëtarët e familjes të parashikuar në nenin 11, paragrafi 2, do të kryhen mbi bazën e një shume fikse për të cilën institucionet do të bien dakord në vijim.

KREU 2

PËRFITIMI I PENSIONIT TË PLEQËRISË, INVALIDITETIT DHE FAMILJAR

Neni 16

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Në rast se sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, fitimi, ruajtja ose rinjohja e së drejtës së përfitimit është e kushtëzuar me periu-dhën plotësuese të sigurimit, organi kompetent i asaj pale kontraktuese, e merr parasysh, nëse është e nevojshme, edhe vjetërsinë e punës të plotësuar sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese, sikur ajo të jetë plotësuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore, me kusht që periudhat të mos mbivendosen, vetëm nëse s'është përcaktuar ndryshe me këtë marrëveshje.

2. Gjatë zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, periudha e sigurimit, që sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese, konsiderohet si periudhë sigurimi me kohë të zgjatur, gjatë përfitimit të së drejtës do të merret parasysh në zgjatjen efikase.

3. I siguruari në njërën palë kontraktuese, i cili dhe me zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni, nuk i plotëson kushtet për të drejtën e përfitimit, institucioni kompetent e merr parasysh edhe vjetërsinë e punës së plotësuar në një shtet të tretë me të cilin të dyja palët kontraktuese kanë nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen shoqërore, ku është parashikuar bashkimi i periudhave të sigurimit, të plotësuara në shtetet e treta. Nëse me shtetin e tretë ekziston një marrëveshje e lidhur për sigurimet shoqërore, vetëm njëra palë kontraktuese, institucioni i asaj pale kontraktuese për shtetasit e vet e merr parasysh periudhën e sigurimit të plotësuar në shtetin e tretë.

4. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, e drejta e përfitimit në kohë të caktuar

është kushtëzuar me plotësimin e vjetërsisë së punës sipas profesionit ose punës, apo aktivitetit të caktuar për të cilin ekziston një sistem i posaçëm, institucioni i asaj pale kontraktuese e merr në konsideratë edhe periudhën e sigurimit, që sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese është plotësuar për të njëjtin profesion apo punë, ose sipas të njëjtit sistem.

Neni 17

Periudha e sigurimit më e vogël se 12 muaj

1. Nëse periudha e përgjithshme e sigurimit, e cila sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese merret parasysh në llogaritjen e përfitimit është më e shkurtër se 12 muaj, nuk pranohet e drejta e përfitimit, me përjashtim të rasteve kur, sipas atyre dispozitave ligjore, ekziston e drejta e përfitimit vetëm në bazë të asaj periudhe sigurimi.

2. Periudha e sigurimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, në bazë të të cilit institucioni përgjegjës i njërës palë kontraktuese nuk e miraton përftimin, këtë e merr parasysh institucioni kompetent i palës tjetër kontraktuese për fitimin, ruajtjen dhe rinjohjen e së drejtës së përfitimit, si dhe për përcaktimin e masës së këtij përfitimi, sikur peri-udha e sigurimit të jetë realizuar në përputhje me dispozitat e saj ligjore.

Neni 18

Përcaktimi i përftimit të pavarur

Nëse, sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, ekziston e drejta e përfitimit edhe pa zbatimin e nenit 16 të kësaj marrëveshje, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese e përcakton përfitimin për periudhën e sigurimit që merret parasysh sipas atyre dispozitave ligjore.

Neni 19

Përcaktimi dhe përllogaritja e pjesës proporcionale të përfitimit

1. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese ekziston e drejta e përfitimit vetëm me zbatimin e nenit 16 të kësaj marrëveshjeje, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese e përcakton përfitimin, në mënyrë që:

1.1 Llogarit masën teorike të përfitimit që do t'i kishte takuar, nëse periudha totale e sigurimit që merret parasysh në përllogaritjen e përfitimit, është plotësuar sipas dispozitave ligjore që zbaton. Masa e përfitimit, e cila nuk varet prej kohëzgjatjes së periudhës së sigurimit, merret si masë teorike;

1.2 Në bazë të masës së përllogaritur sipas pikës 1.1 të këtij neni, përcaktohet masa e përfitimit, që është në proporcion me raportin midis periudhës së sigurimit të plotësuar vetëm sipas dispozitave ligjore që ai zbaton dhe periudhës totale të sigurimit që ai merr parasysh në përllogaritjen e përfitimit;

1.3 Përcakton masën e përfitimit në proporcion me periudhën e sigurimit të plotësuar sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese dhe periudhës së saj më të gjatë të sigurimit, në bazë të së cilës përcaktohet masa e përfitimit, në rastin kur periudha totale e sigurimit, që merret parasysh duke zbatuar nenin 16 të kësaj marrëveshjeje është më e madhe se periudha më e gjatë e sigurimit sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, masa e përfitimit llogaritet në bazë të të ardhurave, pagës, normës bazë të sigurimit, d.m.th. kontributeve të paguara për një periudhë të caktuar kohore, institucioni përgjegjës merr parasysh të ardhurat, pagën, normën bazë të sigurimit, d.m.th. kontributet e paguara, vetëm prej periudhës së sigurimit të plotësuar sipas dispozitave ligjore që ai zbaton.

Neni 20

Reduktimi, ndërprerja dhe anulimi i pagesës së përfitimit

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, duhet të merren parasysh dispozitat ligjore të të dyja palëve kontraktuese me të cilat rregullohet reduktimi, ndërprerja ose anulimi i pagesës së përfitimit.

KREU 3

AKSIDENTI NË PUNË DHE SËMUNDJA PROFESIONALE

Neni 21

Aksidentimi gjatë rrugës deri te vendi i punës

1. Personi me vendbanim në territorin e njërës palë kontraktuese, i cili gjatë rrugës për të shkuar, në punë në bazë të marrëveshjes për punësim ose për ushtrimin e aktivitetit të pavarur në palën tjetër kontraktuese, aksidentohet, ka të drejtën e përfitimit nga aksidenti në punë sipas dispozitave ligjore dhe në ngarkim të palës tjetër kontraktuese.

2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet edhe në rastet e aksidentimit, që pëson personi menjëherë pas skadimit të marrëveshjes së punës, d.m.th. pas ndërprerjes së ushtrimit të aktivitetit të pavarur, rrugës deri te vendbanimi.

Neni 22

Përfitimi në natyrë

1. Personi i cili në bazë të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale ka të drejtën e kujdesit shëndetësor sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, i cili ka vendbanim apo vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, e përfiton këtë kujdes në ngarkim të institucionit kompetent, nga institucioni i asaj zone në të cilën ka vendbanim apo vendqëndrimin, sipas dispozitave ligjore që zbatohen, sikur ai të jetë i siguruar aty.

2. Për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në vlerë më të madhe, zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafi 4 i kësaj marrëveshjeje.

3. Për rastet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, realizimin e së drejtës për kujdes shëndetësor e siguron:

- në Republikën e Shqipërisë - Instituti i Kuj-desit Shëndetësor;
- në Republikën e Maqedonisë - Shërbimi Rajo-nal i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqe-donisë.

4. Për kompensimin e shpenzimeve të shkak-tuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, zba-tohen dispozitat e nenit 15 të kësaj marrë-veshjeje.

Neni 23

Sëmundja profesionale

1. Nëse përfitimi në rastin e sëmundjes profesionale sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, është kushtëzuar me faktin që sëmundja të jetë përcaktuar për herë të parë nga mjeku në territorin e atij shteti kontraktues, konsiderohet se ai kusht është plotësuar, në rast se ajo sëmundje për herë të parë është konstatuar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

2. Nëse miratimi i përfitimit në rastin e sëmundjes profesionale sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, është kushtëzuar nga sëmundja të jetë përcaktuar për herë të parë nga mjeku në territorin e atij shteti kontraktues, konsiderohet se ai kusht është plotësuar, në rast se ajo sëmundje për herë të parë është konstatuar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

3. Nëse miratimi i përfitimit në rastin e sëmundjes profesionale, sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese është kushtëzuar nga ushtrimi i aktivitetit që mund ta shkaktojë atë sëmundje, të

ketë zgjatur për një periudhë kohore të caktuar, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese, nëse nevojitet, e merr në konsideratë edhe kohën e ushtrimit të atij aktiviteti sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese.

Neni 24

Përfitimi në para

1. Përfitimi në para në rastet e aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale e miraton, sipas dispozitave të veta ligjore, institucioni kompetent i asaj pale kontraktuese në territorin e së cilës është shkaktuar aksidenti në punë, d.m.th. aty ku për herë të fundit është ushtruar aktiviteti që ka shkaktuar sëmundjen profesionale.

2. Nëse në person i cili në bazë të sëmundjes profesionale ka marrë apo merr përfitime në para, në ngarkim të institucionit kompetent të njërës palë kontraktuese, për shkak të përkeqësimit të sëmundjes së shkaktuar gjatë ushtrimit të aktivitetit, i cili sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese mund të shkaktojë sëmundje profesionale, paraqet kërkesë për përfitim të institucionit kompetent të palës tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i palës së parë kontraktuese vazhdon edhe më tej t'i mbulojë shpenzimet e përfitimit, pa marrë parasysh përkeqësimin e gjendjes shëndetësore sipas dispozitave ligjore. Institucioni kompetent i palës tjetër kontraktuese miraton përfitimin, në masën e diferencës ndërmjet përfitimit të shkaktuar nga sëmundja dhe përfitimit për shkak të përkeqësimit të sëmundjes që i takon sipas dispozitave të saj ligjore.

Neni 25

Njoftimi i misionit diplomatik apo përfaqësisë konsullore për aksidentin në punë

Për aksidentimin në punë të shtetasit ose personit të siguruar në njërën palë kontraktuese, që ka shkaktuar ose mund të shkaktojë vdekje, institucioni kompetent, menjëherë vë në dijeni misionin diplomatik apo përfaqësinë konsullore të palës kontraktuese, shtetas i të cilit është personi i siguruar.

KREU 4

PËRFITIMI NË RAST VDEKJEJE

Neni 26

E drejta e përfitimit

Përfitimi në rast vdekjeje u takon sipas dispozitave ligjore të asaj pale kontraktuese, në të cilin personi që ka ndërruar jetë, ka pasur vendbanimin.

PJESA IV

DISPOZITA TË TJERA

Neni 27

Zbatimi i marrëveshjes

Organet kompetente me marrëveshje adminis-trative i përcaktojnë institucionet zbatuese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 28

Detyrimet e organeve kompetente, ndihma ligjore dhe administrative

1. Organet kompetente të palëve kontraktuese, me marrëveshje administrative e përcaktojnë mënyrën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje që hyn në fuqi në të njëjtën kohë me këtë marrëveshje.

2. Organet kompetente dhe institucionet e palëve kontraktuese do të informohen ndërmjet tyre, në lidhje me:

1.1 të gjitha masat e ndërmarra për zbatimin e kësaj marrëveshjeje;

1.2 të gjitha ndryshimet e dispozitave ligjore që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, organet dhe institucionet kompetente e palëve kontraktuese në mënyrë të ndërsjellë do të ofrojnë ndihmë ligjore dhe administrative falas.

4. Organet dhe institucionet kompetente të palëve kontraktuese, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, do të kontaktojnë ndërmjet tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe me personat e interesuar apo të autorizuarit e tyre.

5. Organet dhe institucionet kompetente të njërës palë kontraktuese nuk mund ta refuzojnë kërkesën apo aplikime të tjera për shkak se janë shkruar në gjuhën zyrtare dhe me alfabetin e palës tjetër kontraktuese.

6. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, në mënyrë të barabartë do të përdoret gjuha maqedonase me alfabetin e saj dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj.

7. Kontrollet mjekësore që kryhen vetëm në zbatim të dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, por që kanë të bëjnë me personat të cilët kanë vendbanim apo vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, do të kryhen me kërkesën e institucionit, sipas vendbanimit apo vendqëndrimit. Kontrollet mjekësore që kryhen në zbatim të dispozitave ligjore të të dyja palëve kontraktuese, do të kryhen në ngarkim të institucionit sipas vendbanimit apo vend-qëndrimit të personit.

8. Ndihma ligjore, deri në ngritjen e procesit gjyqësor, jepet në përputhje me dispozitat që zbatohen për ndihmën juridike në çështjet ligjore civile.

Neni 29

Misionet diplomatike dhe përfaqësitë konsullore

Misionet diplomatike dhe përfaqësitë konsullore të palëve kontraktuese mund t'u drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa autorizim të posaçëm, organeve dhe institucioneve kompetente të palës tjetër kontraktuese për mbrojtjen e interesave të shtetasve të vet.

Neni 30

Përjashtimi nga shpenzimet administrative

1. Në zbatim të kësaj marrëveshje, përjashtimi ose reduktimi i shpenzimeve administrative, të parashikuara me dispozitat ligjore të njërës palë kontraktuese, për aplikimet apo dokumentet që dorëzohen në zbatim të dispozitave të saj ligjore, vlen për të njëjtat kërkesa dhe dokumente që dorëzohen sipas dispozitave ligjore edhe për palën tjetër kontraktuese.

2. Dokumentet dhe aplikimet të çfarëdolloji që dorëzohen, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, nuk legalizohen.

Neni 31

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa, deklarata ose çdo mjet ligjor, që në zbatim të kësaj marrëveshjeje apo të dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese, i paraqitet organit, institucionit apo një organizate tjetër kompetente, enti apo institucioni të njërës palë kontraktuese, konsiderohet si të jetë paraqitur pranë organit përkatës të palës tjetër kontraktuese.

2. Kërkesa për përfitim, e paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore të njërës palë kontraktuese, në të njëjtën kohë konsiderohet si kërkesë për të njëjtin përfitim edhe sipas dispozitave ligjore të palës tjetër kontraktuese.

3. Kërkesa, deklarata apo mjeti ligjor, që në zbatim të dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese duhet t'i paraqitet organit, institucionit, ndonjë organizate tjetër kompetente, enti ose institucioni të asaj pale kontraktuese, brenda të njëjtit afat kohor mund të paraqitet pranë

institucionit përkatës të palës tjetër kontraktuese.

4. Në rastet e paragrafit 1 deri 3 të këtij neni, organi, institucioni ndonjë organizatë tjetër kompetent ose enti, pa vonesë, përcjell kërkesën, deklaratën apo mjetin ligjor të institucionit përkatës të palës tjetër kontraktuese, vetëm ose përmes institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshjeje.

5. Dokumentet zyrtare, vërtetimet, të cilat në zbatim të kësaj marrëveshjeje i lëshojnë organet apo institucionet e njërës palë kontraktuese, konsiderohen të vlefshme edhe për organin apo institucionin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 32

Pagesa e përfitimeve

1. Institucioni kompetent për dhënien e përfitimit sipas kësaj marrëveshjeje, e realizon pagesën e përfitimit për përfituesit, në monedhën e vet kombëtare.

2. Transferimi i përfitimeve në monedhën e palës tjetër kontraktuese kryhet sipas kursit të këmbimit që është i vlefshëm ditën kur insti-tucioni kompetent për dhënien e përfitimeve i kalon fondet organit pagues në shtetin e vet, për dhënien pagesës përfituesit në shtetin tjetër kontraktues.

3. Përfitimet në para, të parashikuara me këtë marrëveshje, paguhen në monedhën e asaj pale kontraktuese, në të cilën ndodhet institucioni zbatues, tek i cili kalojnë përfitimet.

4. Pagesa e parashikuara me paragrafët 1 deri 3 të këtij neni, kryhen në monedhën e konvertuar në përputhje me qarkullimin monetar midis dy palëve kontraktuese.

Neni 33

Kërkesa për përfitime të paguara më tepër

1. Institucioni i njërës palë kontraktuese, i cili ka paguar përftimet në masë më të madhe se ajo që i takon përfituesit, në bazë të dispozitave ligjore, mund t'i kërkojë institucionit të palës tjetër kontraktuese, që të mbajë pjesën e përfitimit që i është dhënë më tepër përfituesit.

2. Shuma e paguar tepër, sipas paragrafit 1 të këtij neni, i kalon direkt institucionit i cili ka kërkuar mbajtjen e saj.

Neni 34

Procedura ekzekutive

1. Vendimet ekzekutive në fushën e sigurimeve shoqërore të organeve dhe institucioneve kompetente, si dhe vendimet ekzekutive të gjykatave të njërës palë kontraktuese njihen edhe nga pala tjetër kontraktuese.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm nëse është në kundërshtim me rendin publik të palës kontraktuese në të cilën duhet të njihet akti ose vendimi ekzekutiv, të parashikuar me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Aktet dhe vendimet ekzekutive, prej paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen në përputhje me dispozitat ligjore që lidhen me vendimet ose aktet ekzekutive të palës kontraktuese në të cilën duhet të zbatohen. Vendimet ose aktet ekzekutive duhet të përmbajnë vërtetimin që konfirmon zbatueshmërinë e tyre.

4. Zbatimi i paragrafëve 1 deri 3 të këtij neni nuk e përfshin përfaqësimin në procesin gjyqësor.

Neni 35

Kompensimi i dëmit

1. Nëse në person, i cili sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontrkteuse merr përfitime për shkak të dëmit të shkaktuar në palën tjetër kontraktuese, sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të palës së parë kontraktuese dhe nëse institucioni ka të drejtën e kompensimit të dëmit prej personit të tretë, atëherë e drejta e këtij kompensimi i kalon institucionit të palës së parë kontraktuese, nëse kjo është parashikuar sipas dispozitave të saj ligjore.

2. Nëse e drejta e kompensimit të dëmit lidhet me përfitime të njëjta, për të njëjtin rast të dëmit të kaluar tek institucionet e të dyja palëve kontraktuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi i tretë mund t'ia paguajë kompensimin e dëmit me vullnet të lirë, njërit apo tjetrit institucion, në proporcion me përfitimet që janë paguar.

Neni 36

Mbrojtja e të dhënave

Institucionet e të dyja palëve kontraktuese përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të shkëmbejnë të dhëna personale. Të dhënat personale të individëve, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të shkëmbehen nga njëra palë kontraktuese te pala tjetër, në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për realizimin e të drejtës së përfitimeve të parashikuar me këtë marrëveshje. Të gjitha shkëmbimet e të dhënave mes palëve kontraktuese do të jenë me përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të të dyja palëve kontraktuese.

Neni 37

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të dalin gjatë zbatimit dhe interpretimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhin nga organet kompetente të palëve kontraktuese nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të përbashkëta.

PJESA V

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Dispozitat kalimtare

1. Kjo marrëveshje zbatohet edhe për rastet e të siguruarve që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të saj.

2. Kjo marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë përfitimi për rastet e ndodhura para hyrjes në fuqi të saj.

3. Të gjitha periudhat e sigurimeve, të realizuara sipas dispozitave ligjore të njërës palë kontraktuese para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, merren në konsideratë në përcaktimin e së drejtës së përfitimit, të fituara në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

4. Kjo marrëveshje nuk zbatohet për të drejtat që janë shlyer me miratimin e një shume bazë ose kontributeve të kthyera.

Neni 39

Hyrja në fuqi

1. Palët kontraktuese, në mënyrë të ndërsjellë, me shkresë zyrtare, në rrugë diplomatike, do të njoftohen për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore që janë të domosdoshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit vijues pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 40

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohore të papërcaktuar.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet vetëm me miratimin e dyanshëm të palëve kontraktuese, përmes shkresave zyrtare. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi sipas procedurës dhe mënyrës që parashikohet në nenin 39 të kësaj marrë-veshjeje.

3. Kjo marrëveshje mund të shfuqizohet me miratimin e dyanshëm të palëve kontraktuese ose në mënyrë të njëanshme, me shkresë zyrtare të dorëzuar në rrugë diplomatike, Në këtë rast marrëveshja do të shfuqizohet pas gjashtë muajsh pas marrjes së shkresës zyrtare nga pala tjetër kontraktuese.

Në rast të shfuqizimit, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të vazhdojnë të zbatohen për rastet që lidhen mbi të drejtat e fituara, si dhe në lidhje me kërkesat për realizimin e të drejtave të paraqitura para marrjes së miratimit të dyanshëm për shfuqizim, respektivisht para dorëzimit të njoftimit me shkrim nga njëra palë për shfuqizimin e kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Shkup, më 17 mars 2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe maqedonase, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.